



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:140194

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05511526

C.nr.305/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Naim Rekalju, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.G. nga fshati Bukosh, Komuna e Vushtrrisë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. R.B. , me seli të zyrës në Vushtrri, kundër të paditurës Q. në Vushtrri, për shkak të kompensimit të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, me vlerë të kontestit 1,467.00 euro, jashtë seancës, me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit I.G. nga fshati Bukosh, Komuna e Vushtrrisë, me të cilën ka kërkuar që të “DETYROHET e paditura Q. në Vushtrri që të bëjë kompensimin e paditësit me rastin e pensionimit, në lartësi të tri pagave me vlerë nga 1,467.00 euro me kamatë ligjore-vjetore prej 8%.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi I.G. nga fshati Bukosh, Komuna e Vushtrrisë, nëpërmjet të autorizuarit të tij av. Rifat Bllata, me datë 08.07.2022 ka paraqitur padi kundër të paditurës Q. në Vushtrri, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura, që në emër kompensimit të tri pagave përcjellëse me rastin e

pensionimit, t'ia paguaj paditësit shumën prej 1,467.00 euro, ngase paditësi është pensionuar me datën 26.05.2022.

E paditura K. në përgjigje në padi, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetim se e paditura nuk ka qene pjesëmarrëse ne marrëdhëniet detyrimore dhe nuk ka marrë obligime për përmbushjen e këtyre detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Sektoriale e Shëndetësisë si dhe Kontrata Sektoriale e Shëndetësisë, ka pushuar se vlejtori me datë 11.06.2021, dhe kjo është përcaktuar edhe në nenin 2 par. 1 të saj.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurit, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa themeltë andaj pa shqyrtim të çështjes, e refuzoj kërkesëpadinë e paditëse.

Gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit mbi refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses jashtë seancës, në kuptim të nenit 399 i LPK-së, sipas të cilit “Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 399 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë.

Mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, kontestuese nuk ishte as fakti se paditësi ka dal në pension, kontestuese nuk ishte po ashtu as rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë nuk ka bërë kompensimin e tri pagave përcjellëse paditëses me rastin e daljes në pension, por kontestuese ishte baza mbi të cilën mbështet kërkesëpadia, përkatësisht mungesës së bazës ligjore mbi të cilën paditësja kërkon realizmin e tri pagave përcjellëse në pension.

Nga përmbajtja e vet padisë vërtetohet se paditësi ka dalë në pension me datë 26.05.2022.

Andaj, duke u bazuar në kohën kur paditësi ka dalë në pension dhe nenin 399 të LPK-së, gjykata gjeti se kërkesëpadia është qartazi në kundërshtim me faktet e treguara në padi, ngase sipas fakteve të treguara në padi dhe të drejtës materiale, nuk rezulton themelësia e kërkesëpadiës, e krejt kjo duke u bazuar në nenin 2 par. 1 dhe 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale, të datës 11.06.2018, në të cilët përcaktohet se “1. Afati i zbatimit të kësaj kontrate është në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet nga data e lidhjes së saj, respektivisht nga momenti i nënshkrimit nga palët në këtë kontratë, dhe gjen zbatim deri në lidhjen e kontratës së re. 2. Me kalimin e afatit sipas paragrafit 1 të këtij neni, palët mund të vazhdojnë KKS-në për afat të ri apo të lidhin kontratën e re”, po ashtu në nenin 36 par. 1 të të njëjtës kontratë, përcaktohet se “Kontrata Kolektive Sektoriale hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga ana e palëve nënshkruese”, ndërsa kontrata është nënshkruar me datë 11.06.2018.

Gjykata duke llogaritur kohëzgjatjen e kontratës sipas nenit 2 të saj, prej 3 viteve, dhe kohën e hyrjes së saj në fuqi me datë 11.06.2018, gjeti se kontrata ka pasur efekt juridik deri me datë 11.06.2021, andaj duke vlerësuar bazën ligjore në raport me faktet e treguara në padi, del se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar, e krejt kjo për faktin se paditësi ka dalë në pension me datë 26.05.2022, që do të thotë pasi që ka skaduar Kontrata Kolektive Sektoriale dhe rrjedhimisht me skadimin e kontratës, ka pushuar edhe baza ligjore për kërkesat e arritura pas datës 11.06.2021.

Për vendosjen si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata u bazua në nenin 450 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.305/2022, me datë 27.03.2024

Gj y q t a r i
Naim Rekalii

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.